



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V_948_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1567_05_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **03.10.2017**.

në seancën e mbajtur më datë **29.03.2018**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHE**t ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.P. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPZ - 90108399** si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1567_05_17** i datës 15.05.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: te konsumatori me datë 23.12.2016 është bërë ndërrimi i të dhënave të njehsorit nga 64675866 në 64675861 dhe ky ndërrim është bërë përmes procesverbalit të inspektimit. Në ankesë theksohet se procesverbalet nr.2215885 dhe 2215886 të shifrat DPR – 901008399 dhe DPR – 41648 konfirmojnë se te konsumatori është permutacion i numrave dhe kemi pasur se shpenzimi i njërit konsumator është faturuar te tjetri dhe anasjelltas. Për shkak të këtyre gabimeve është korrigjimi financiar në vlerë prej -60.99€. Në ankesë theksohet se KESCO duhet të bëjë korrigjim edhe te shifra DPR – 90108399 pasi që në periudhën 12/2016 është bërë ngarkesa për të cilën është shpenzuar realisht.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE _V_1567_05_17, në lidhje me shifrën DPR – 90108399 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit se te rasti i konsumatorit kemi permutacion të numrave dhe se shpenzimi i njërit konsumator është faturuar te tjetri dhe anasjelltas, Bordi i ZRRE thekson se në asnjërin prej shkresave të KEDS-it nuk është evidentuar se kemi të bëjmë me permutacion të numrave të njehsorit dhe se shpenzimet e shifrave DPR – 90108399 dhe DPR – 41648 janë gabim dhe se duhet të korrigojohen. Madje edhe procesverbali i cekur në ankesë nr.2215585 dhe nr.2215886 të datës 23.12.2016 nuk janë të evidentuara te përgjigja e KESCO dhënë konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike të konsumatorit ka konstatuar se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese është pothuajse konstante. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para periudhës kontestuese 11/2015 deri më 11/2016 është 390.62 kWh/muaj apo në vlerën financiare prej 24.43€, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para periudhës kontestuese 01/2017 deri më 04/2017 është 430.50 kWh/muaj, apo në vlerën financiare prej 31.42€.

Bordi gjithashtu ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit sipas sezonave dhe ka vërejtur se nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike mes sezonave. Nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit për sezonën verore vërehet se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 04/2016 deri më 09/2016 është 465.5 kWh/muaj apo në vlerë financiare prej 25.76€, ndërsa për sezonën dimërore mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 01/2017 deri më 03/2017 është 452.00 kWh/muaj, apo në vlerë financiare prej 32.71€. Bazuar në analizën e theksuar më lartë mund të konstatojmë se vlera e faturuar prej 154 € për muajin 12/2016 nuk përkon me gjendjen reale të shpenzimit të energjisë elektrike që bënë konsumatori, pasi që shpenzimi para dhe pas kësaj periudhe (12/2016) është i pothuajse i njëjtë.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe listat e leximit të KEDS dhe se nga listat e leximit të konsumatorit që përfshijnë periudhën kohore 09/2016 deri më 03/2017 shihet se pika matëse e konsumatorit është lexuar me rregull dhe nuk ka ndonjë parregullësi në lexim. Pra në listat e leximit nuk evidentohet se është bërë permutacion i numrave të njehsorëve.

Gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës Bordi i ZRRE ka konstatuar se shpenzimi i energjisë elektrike i faturuar i konsumatorit në pikën matëse ka mund të jetë edhe si pasojë e ndonjë çrregullimi të mundshëm të pajisjes matëse për faktin se në asnjë parametër nuk tregon se konsumatori ka mund të shpenzoi një sasi të tillë të energjisë elektrike kur marrim për bazë shpenzimin para periudhës kontestuese dhe pas periudhës kontestuese. Andaj për të vërtetuar më saktë punëtoret e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikave matëse kanë pas obligim që të bëjnë një shqyrtim të saktë sa i përket gjendjes teknike të njehsorit elektrik por jo të dhënë vetëm mendime në atë që e shohin vetëm vizualisht me sy.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore mund të konstatojmë se në rastin konkret konsumatori ka pasur obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë me një vlerë shumë të lartë e cila ka mund të jetë për shkak të problemeve teknike në njehsorin elektrik

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A. P. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.